REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 38855
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 28/12
KAMENICË/A 2021

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikes së Kosovës", nr.28/15, qershor 2008), nenit 78 shkronja g) të Statutit Sh.01 Nr.15 dt.31.05.2010 të Komunës së Kamenicës , Kryetari i Komunës merr këtë:

**URDHËRESË**
**Për ndalimin e përdorimit të produkteve piroteknike**

1. NDALOHET përdorimi i produkteve piroteknike në vendet e hapura publike, përkatësisht në tregje, rrugë dhe sheshe.

2. Ndalesa sipas pikës 1 (një) të kësaj urdhërese vlenë për periudhën prej 30 dhjetorit 2021 deri më 03 janar 2022.

3. Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese, do të gjobiten në shumë prej 100€.

4. Për zbatimin e kësaj urdhërese kujdeset Sektori i Inspektoratit.

5. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj.

T'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Inspektoratit, Zyrës për Përkthime dhe QSHQ-së

Krytari i Komunës
Kadri Rahimaj